

Testoni njohuritë tuaja 1 - E-Games

Sipas SNRF 8 dy ose më shumë segmente shfrytëzimi mund të grumbullohen në një segment të vetëm nëse ato kanë karakteristika ekonomike të ngjashme dhe segmentet janë të ngjashëm në aspektet e mëposhtme:

- Natyrën e produkteve ose shërbimeve.
- Llojet ose kategoritë e klientëve.
- Metodat e shpërndarjes.

Standardi thotë se segmentet me karakteristika ekonomike të ngjashme do të kishin marzhe fitimi bruto afatgjatë të njëjta.

Dyqanet E-Games dhe biznesi online shesin lloje produkti të njëjta dhe ka të ngjarë të mos ketë dallime të mëdha në kategoritë e klientëve (konsumatorët individualë). Prandaj, në këto aspekte, segmentet janë të ngjashëm.

Pavarësisht se klientët do të marrin mallrat e tyre nga dyqanet, E-Games do të ofrojë produktet e shitura në internet. Kjo nënkupton që metodat e shpërndarjes janë të ndryshme.

Për më tepër, ekzistojnë çmime të ndryshme shitjesh midis dyqaneve dhe biznesit në internet, gjë që shkakton diferenca të konsiderueshme në marzhin bruto. Kjo sugjeron ndryshime në lidhje me karakteristikat ekonomike.

Kjo do të thotë se mund të jetë më e përshtatshme që këto dy segmente të shpjegohen veçmas.

Shënim:

Këtu nuk ka përgjigje 'të vërteta' ose 'të gabuara'. Ka shumë shitës me pakicë që nuk japin shënime shpjeguese për punën e tyre në internet si një segment më vete. Sidoqoftë, Bordi vëren në rishikimin e tij pas implementimit të SNRF 8 se shumë kompani janë segmente të bashkuara. Për qëllime provimi, është e rëndësishme të theksohen kriteret përkatëse të njohjes dhe pastaj këto të zbatohen në informacionin e dhënë në pyetje.

Testoni njohuritë tuaja 2- Identifikimi i segmenteve raportues**Testi 10 %**

Segmenti	10 % e të ardhurave totale (W1)	10% e rezultateve tw testit (W2)	10% e aktiveve (W3)	Raporti ?
Europa	Y	Y	Y	Y

Lindja e Mesme	N	N	N	N
Azia	Y	Y	Y	Y
Amerika e Veriut	Y	Y	Y	Y
Amerika Qendrore	N	N	N	N
Amerika e Jugut	N	N	N	N

Evropa, Azia dhe Amerika e Veriut janë të raportueshme. Sidoqoftë, duhet të kontrollojmë nëse ato përbëjnë të paktën 75% të të ardhurave të jashtme të kompanisë.

Testi 75 %

	Të ardhurat e jashtme
	000 \$
Europa	140
Azia	150
Amerika e Veriut	195
<hr/>	<hr/>
Totali	485

Të ardhurat e jashtme të krijuara nga segmentet e raportueshme janë 79% (485,000 \$ / 612,000 \$) e të ardhurave totale të jashtme. Testi 75% është përmbushur dhe asnjë segment tjetër nuk duhet të raportohet.

Përfundimi

Segmentet raportuese janë Evropa, Azia dhe Amerika e Veriut.

(W1) 10% e shitjeve totale

$$10\% \times 1 \text{ mln } \$ = 100,000 \$$$

Të gjitha segmentet, shitjet totale të të cilëve kalojnë 100,000 \$ janë të raportueshme.

(W2) 10% e rezultateve

10% e fitimit të segmenteve:

$$10\% \times (98,000 \$ + 47,000 \$ + 121,000 \$ + 12,000 \$) = 27,800 \$$$

10% e humbjeve të segmenteve:

$$10\% \times (26,000 \$ + 15,000 \$) = 4,100 \$$$

Prandaj, të gjitha segmentet që kanë një fitim ose humbje më të madhe se 27,800 \$ janë të raportueshëm.

(W3) 10% e totalit të aktiveve

$$10\% \times 10 \text{ mln } \$ = 1 \text{ mln } \$.$$

Të gjitha segmentet, aktivet e të cilave kalojnë 1 mln \$ janë të raportueshëm.